



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1223/prot.  
1

Tiranë më 6.10.2017

V E N D I M

Nr. 91, datë 6.10.2017

PËR

LEJIMIN E TRANSFERIMIT NDËRKOMBËTAR

Në mbështetje të nenit 9 dhe pikës 1 të nenit 26 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, pas shqyrtimit të kërkesës administruar me nr. 1226 prot, datë 13.09.2017, për pajisje me autorizim për transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale nga transferuesi Raiffeisen Bank Sh.a tek marrësi Raiffeisen Bank J.s.c në Kosovë;

KONSTATOVA SE:

Subjekti kontrollues, Raiffeisen Bank Sh.a në Shqipëri ka kërkuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur "Komisioneri") pajisjen me autorizim për transferimin e të dhënave personale tek marrësi Raiffeisen Bank J.s.c, me vendndodhje në Kosovë.

Sipas deklarimeve të subjektit në Formularin e Aplikimit për Aprovimin e Transferimit të të Dhënave Personale në një Shtet që nuk ka Nivel të Mjaftueshëm të Mbrojtjes së të Dhënave, administruar pranë Zyrës së Komisionerit, transferimi që kërkohet të autorizohet nga Komisioneri përmban elementët e mëposhtëm:

Kategoria e të dhënave objekt transferimi:

1. Të dhënat e identifikimit (emër, mbiemër, gjinia, inicialet, vendlindja, datëlindja);
2. Numri personal i identifikimit;
3. Jeta profesionale;
4. Numri i sigurimit shoqëror;
5. Situata ekonomike e financiare;
6. Formimi - Diplomat – Medaljet;
7. Adresa, karakteristikat e banesës.

Shteti ku do të realizohet transferimi: Kosovë.

Kategoria e subjekteve të cilëve u transferohen të dhëna personale janë: Klientë.

Frekuenca e Transferimit është: Vazhdimisht.

Qëllimi i transferimit, citojmë: *“Raiffeisen Bank Sh.a së bashku me Raiffeisen Bank Kosovë po synojnë optimizimin dhe përmirësimin cilësor të ruajtjes dhe menaxhimit të sigurtë të paisjeve dhe sistemeve operuese. Për këtë qëllim, bankat po analizojnë dhe synojnë sinergjitë në përdorimin e siteve primare të tyre si site sekondare për njëra tjetrën. Bazuar dhe në standardet më të mira ndërkombëtare, direktivat e grupit dhe ato europiane por dhe në kërkesat lokale për ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave dhe informacionit, i jepet prioritet i lartë standardeve të larta të menaxhimit dhe funksionimit të siteve primare dhe sekondare si dhe të dhënave që administrohen në to. Gjithashtu, një element tepër i rëndësishëm është largësia mes site primar dhe atij sekondar, si dhe mitigimi i risqeve potenciale të vendeve përkatëse duke aplikuar parimin e diversitetit në lokacion, në profil risku etj. Për këtë qëllim, në përmbushje të nenit 11 të Rregullores 3 datë 09.01.2011 të miratuar nga Banka e Shqipërisë “Për Administrimin e Riskut Operacional”, në këtë mënyrë synohet të sigurohet vazhdimësia e aktivitetit në rast të ndodhisë së një eventi të jashtëzakonshëm”.*

Ndërkohë në Rubrikën 7, të Formularit të Aplikimit “Rrethanat lidhur me përpunimin” subjekti transferues ka deklaruar, citojmë: *“Bazuar në qëllimet e transferimit dhe në kuadër të minimizimit të risqeve të alokuara lidhur me vazhdimësinë e biznesit, po planifikohet ky hap paraprak në kuadër të konsolidimit të sistemeve të teknologjisë informative”.*

Kohëzgjatja e ruajtjes së të dhënave, citojmë: *“Të dhënat personale do të ruhen bazuar në legjislacionin shqiptar në fuqi. Marrëdhënia juridike mes të dyja bankave do të jetë për një afat të pacaktuar”.*

Në bazë të Vendimit të Komisionerit Nr. 8, datë 31.10.2016 “Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”, Kosova nuk është në listën e vendeve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave.

Në këto kushte në zbatim të nenit 9 pika 1, të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, subjekti kontrollues Raiffeisen Bank Sh.a në Shqipëri është në kushtet ku ky transferim duhet kryer pas marrjes së Autorizimit nga Komisioneri mbi ligjshmërinë e realizimit të tij.

Në mbështetje të dokumentacionit të paraqitur nga kontrolluesi dhe studimit të përmbajtjes së tyre rezulton që ky transferim të dhënash personale të jetë në përputhje me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale sipas akteve ndërkombëtare dhe vendase, dispozitat e Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 41, datë 13.06.2014 për “Lejimin e disa kategorive të transferimeve ndërkombëtare të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”.

Sa më sipër, kërkesa për marrjen e autorizimit nga Komisioneri për transferimin e të dhënave personale nga kontrolluesi Raiffeisen Bank Sh.a në Shqipëri plotëson kërkesat ligjore për t’u pajisur me Autorizim për transferimin e të dhënave personale të kërkuara.

## PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, shkronja b, c nenit 9, pika 2 dhe nenit 26 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar;

## V E N D O S A :

1. Lejimin e transferimit ndërkombëtar të të dhënave personale nga kontrolluesi Raiffeisen Bank Sh.a në Shqipëri, si më poshtë:

Kontrolluesi Raiffeisen Bank Sh.a në Shqipëri lejohet të transferojë tek marrësi i të dhënave Raiffeisen Bank J.s.c me vendndodhje në Kosovë, në mënyrë të vazhdueshme, të dhënat personale të klientëve, si më poshtë:

- Të dhënat e identifikimit (emër, mbiemër, gjinia, inicialet, vendlindja, datëlindja);
  - Numri personal i identifikimit;
  - Jeta profesionale;
  - Numri i sigurimit shoqëror;
  - Situata ekonomike e financiare;
  - Formimi - Diplomat – Medaljet;
  - Adresa, karakteristikat e banesës.
2. Të dhënat e cituara më sipër do të transferohen vetëm për qëllimin e deklaruar nga transferuesi në Formularin e Aplikimit për Autorizim mbi Transferimin e të Dhënave Personale, të paraqitur pranë Komisionerit dhe që ka të bëjë me ruajtjen dhe menaxhimin e sigurt të paisjeve dhe sistemeve operuese.
  3. Të dhënat personale të lejuara për t'u transferuar (parashikuar në pikën 1), nuk do të ruhen më gjatë se përfundimi i marrëveshjes midis palëve.
  4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u dha sot më datë 6 / 10 2017

## KOMISIONERI

**Besnik Deryishi**

